



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson znj Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga “Fadil Ferati” Nr. 121 në njërën anë; dhe

PBC SH.P.K të cilën e përfaqëson, i autorizuari z. Bashkim Selmani me nr. Unik të Biznesit, 810845985 (ne vazhdim “Kontraktuesi”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për FURNIZIM e shënuara me poshtë:

### *TITULLI I KONTRATËS:*

*PAISJA ME E-KIOSK NE DOBRUSHË DHE RAKOSH – KOMUNA E ISTOGUT*

Nr. I prokurimit	633 – 20 – 1513– 1 2 1/C342
I brendshëm	633-020 / 018 / 121

### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është furnizimi dhe instalimi i paisjeve si në vijim:

*PAISJA ME E-KIOSK NE DOBRUSHË DHE RAKOSH – KOMUNA E ISTOGUT*

### **2 Çmimi**

2.1 Çmimi i kësajë kontrate në total për dy (2) paisjet-kiosqet është: **13.499,00 €** dhe me fjalë:

**/Trembedhjetëmijëekatërçindenenenëntëdhjeënenëntëzerozeroeuro/**

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- Plani për meaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.




4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

**Komuna e Istogut**

**Për Kontraktorin:**

**PBC SH.P.K**

<b>Emri:</b>	<b>Zizë Bujupaj</b>	<b>Emri:</b>	<b>Bashkim Selmani</b>
<b>Pozita:</b>	<b>Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit</b>	<b>Pozita:</b>	<b>D r e j t o r ,</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	<i>për: Selman</i>
<b>Data:</b>	<i>16.7.2020</i>	<b>Data:</b>	<i>16.07.2020</i>
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</i>
	2.2	<i>Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe dhe gjuha serbe</i>
Siguria e ekzekutimit	8.1	<i>Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, 30 dite me gjate se perfundimi i kontrates.</i>
Cilësia e furnizimeve	16.2	<i>Të gjitha furnizimet duhet të jenë të cilësisë së lartë. Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas perfundimit te aktivitetit dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimet janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</i>
Dorëzimi	19.3	<i>Dorëzimi i furnizimeve duhet të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	<i>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 30.1.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>

## KOMUNA E ISTOGUT

Pajisja me e-Kiosk në Dobrushë dhe Rakosh

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
--	----------------------	------------	-----------	------------------	-----------------

1	Kërkesat harduerike
---	---------------------

1.1	<b>PC Industrial</b> - Industrial Mainboard: CPU: G2030 3.0 GHz; RAM: 8 GB; HDD: 1T; dhe porti i nevojshëm për lidhje periferike me eKioskë. Rezistent ndaj ujit 17" Touch Screen (High Transparency, highprecisionanddurability; Ports:USBantirust, anti-acid, anti-dust, Operating temperature : -30 / +50 oC; resol. 1280x1024)	copë	2	950.0 €	1,900.0 €
1.2	<b>A4 Laser Printer dhe Kaseta</b> , Printer bardh e zi - Kërkesat minimale: Deri në 45 ppm A4 / 210 x 297 mm, 150 sheets + 500 sheets tray, 6.5 seconds, Deri në 1200 x 1200 dpi rezolucioni i printimit, 512 MB Memorie dhe 400MHz CPU, Minimum 2 Kaseta.	copë	2	550.0 €	1,100.0 €
1.3	<b>ThermalReceipt Printer</b> , MS-D347 apo i ngjashëm - Thermal Printer, Letra (in-depth) 80mm, Dots/line:640 dots/line; Rezolucioni: 8; Print Speed: 150mm/s, Automaticcutter; Print width: 72 mm; Paper width: 80 mm; Thickness of paper: 56-150 µm; WxDxH (mm): Head temperature detection: Thermistor; Paper running out alarm; Paper to be run out alarm, Paper jam alarm; Interface:Serial Port/USB	copë	2	400.0 €	800.0 €
1.4	<b>SmartCoinDispenser</b> , CoinAcceptor&SmartHopper apo i ngjashëm - Coin Acceptor and Payout speed: 12 coins/s Support: euro coins 0.10, 0.20, 0.30, 0.50, 1:00, 2:00 Interfaced: USB Coin dimensions: Diameter: 18~28.5mm, Thickedss:1.65~3.2mm MCBF: 100,000		2	800.0 €	1,600.0 €
1.5	<b>ID-Document Scanner</b> - 365 E apo I ngjashëm. i cili duhet të jetë në gjendje të skanoj dy llojet e ID dokumenteve (letërnjoftimeve) të cilët janë në përdorim në Kosovë: ID documents image scan, ID reading, 1D/2D bar code reading, të dizajnuar për mbrojtje nga drita e diellit.	copë	2	650.0 €	1,300.0 €
1.6	<b>UPS (Uninterruptable Power Supply)</b> - duhet të jetë I instaluar si UPS I brendshëm dhe duhet të ketë kapacitet mbi 1000 W	copë	2	75.0 €	150.0 €
1.7	<b>Kamera e sigurisë</b> e integruar në e-Kioskë - SX-608-5M apo e ngjashme me këto veçori: Outdoor 360 Night Vision Camera: IR Distance 10m, CMOS Sensor, Waterproof, 5MP 1080P (Full-HD)	copë	2	94.5 €	189.0 €

2	Kërkesat softuerike
---	---------------------

2.1	<b>Platforma softuerike për kryerjen e funksioneve të eKioskes sipas kërkesave në vijim:</b>		2	3,230.0 €	6,460.0 €
2.1.1	Platforma duhet të zhvillohet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.				
2.2.2	Softueri duhet të jetë modular dhe duhet të ofrojë: 1. Lëshimin e certifikatës së lindjes (prindërit duhet të kenë mundësinë e nxjerrjes për fëmijën nën 18 vjeç). 2. Lëshimin e ekstraktit të lindjes (prindërit duhet të kenë mundësinë e nxjerrjes për fëmijën nën 18 vjeç). 3. Certifikata e martesës 4. Certifikata e shtetësisë 5. Certifikata e vendbanimit				
2.2.3	eKioska duhet të ofrojë mundësinë edhe të shërbimeve të tjera si: - Paraqitja e informatave për tatimin në pronë (opcionale printimi) - Mundësia e paraqitjes së kërkesës në formë elektronike - Mundësia e paraqitjes së ankesës në formë elektronike.				

	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
2.2.4	Softueri duhet të mundësojë ndërlidhjen me sistemin qendror të të dhënave të regjistrit civil. Kjo do të kryhet nga ana e operatorit ekonomik i cili është po ashtu i obliguar që gjatë ofertimit të përshkruaje edhe mënyrën se si do e realizojë.				
2.2.5	Sistemi duhet të ruaj të dhënat e aplikuesit lokalisht dhe në data bazën qendrore të ARC. Operatori ekonomik me rastin e ofertimit duhet ta përshkruajë realizimin.				
2.2.6	Sistemi duhet të ofroj raporte të ndryshme përfshirë raportet ditore, javore dhe mujore.				
2.2.7	eKioska duhet të ofroj komunikim me pajisjet periferike dhe po ashtu për këtë Operatori ekonomik me rastin e ofertimit duhet ta përshkruajë realizimin.				
2.2.8	Sistemi duhet të ketë modulën për autentifikim dhe autorizim përmes ID kardses.				
2.2.9	Databaza duhet të jete ne MS SQL.				
2.2.10	Sistemi operativ duhet të jete i licensuar dhe të ketë antivirus.				
2.2.11	eKioska duhet të jete në gjendje të pranoje kërkesën, të pranoje pagesën dhe të shtyp certifikatën dhe dëshminë e ndërkaq të dhënat të merren ne kohe reale nga sistemi i gjendjes civile. Për këtë operatori ekonomik duhet të jap përshkrimin teknik të realizimit.				
2.2.12	eKioska duhet të ruaje të dhënat në server për secilin qytetar që shërbehet me të.				
2.2.13	Të dhënat e qytetareve gjatë aplikimeve duhet të kenë mundësinë të lexohen përmes një softueri të veçantë që do instalohet ne lokacionet e përcaktuara nga komuna. Ky softuer duhet të zhvillohet nga kompania fituese dhe duhet të: paraqesë të dhënat e LOG-ut, ketë mundësinë e filtrimit, ketë mundësinë e printimit dhe eksportimit ne formatin excel.				
2.2.14	eKioska duhet të ketë çelës shtese për monedha i cili nuk duhet të jete ne miniature.				
2.2.15	Hapja e eKioskes duhet të behet përmes dy çelësve që poashtu nuk duhet të jene ne miniature.				
2.2.16	Përdorimi i eKioskes duhet të ofrohet përmes ekranit të ndjeshëm ne prekje me madhësi se paku 17inch.				
2.2.17	Pranuesi i monedhave duhet të pranoje monedhat si ne vijim: 0.10 euro, 0.20 euro, 0.50 euro, 1.00 euro dhe 2.00 euro. Duhet të detektojë monedhat e dëmtuara, falsifikatet dhe të ktheje kusurin. Duhet të jete i mbyllur me çelës special dhe të ketë mundësinë e hapjes vetëm nga persona të autorizuar.				
2.2.18	eKiosku duhet të ketë mundësinë e zgjerimit të shërbimeve ne të ardhmen.				
2.2.19	Garancioni i eKioskes dhe komponentëve përbërëse duhet të jete 12 muaj. Brenda periudhës garantuese, duhet të ofrohen trajnimet për stafin komunal për përdorim të eKioskes dhe mbushjen me dokumente (për se paku 2 veta).				
2.2.20	Mirëmbajtja e eKioskes dhe pjesëve përcjellëse duhet të jete 12 muaj.				
2.2.21	Ne rast të mosfunksionimit të eKioskes gjate periudhës së garancionit kompania duhet të intervenojë brenda 48 orëve nga lajmërimi dhe duhet të dorëzojë raport të shkruar.				

### REKAPITULIMI

<b>1</b>	<b>Kërkesat harduerike</b>				<b>7,039.0 €</b>
<b>2</b>	<b>Kërkesat softuerike</b>				<b>6,460.0 €</b>
	<b>TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT (GJITHSEJ 1+2)</b>				<b>13,499.0 €</b>